



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.7/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Yenilikci Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, për parregullsitë/shkeljet për ditën e zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 29.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar, ankesa e subjektit politik Yenilikci Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, KDTP, me seli në Prizren, për parregullsitë/shkeljet për ditën e zgjedhjeve, në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025,

A r s y e t i m

Me datë 28.08.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Yenilikci Turk Hareket Partisi, YTHP, me seli në Prizren, në të cilën thekson se, megjithëse selia zyrtare e Partise Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) gjendet në Prizren, në të njëjtin qytet – përballë Shkollës Filllore “Motrat Qiriazit”, ekziston një zyrë jozyrtare, e cila përdoret vetëm gjatë fushatave, veçanërisht në ditën e zgjedhjeve, ku në pjesën e kësaj zyre që është e orientuar kah rruga, vendoset logoja e e KDTP-së, ndërsa në ditën e zgjedhjeve kjo logo mbulohet, me qëllim shmangien e ankesave të mundshme.

Sipas ankesës, në çdo cikël zgjedhor, kjo zyrë mbahet e hapur në ditën e zgjedhjeve prej orës 07:00 deri në 19:00, dhe në hapësirën deri të oborri i shkollës, drejtuesit, kandidatët dhe personat e subjektit politik ndërhyjnë drejtpërdrejt të votuesit duke ndikuar mbi vullnetin e tyre të lirë. Distanca ndërmjet kësaj zyre jozyrtare dhe objektit shkollor i cili përdoret si qendër votimi është përafërsisht 45 metra. Kjo përbën shkelje të qartë në bazë të Rregullores nr. 07/2024, neni 7, pika 2.9. Poashtu parashtruesi i ankesës thekson se deri më sot, kjo gjendje është paraqitur disa herë nga ana jonë në KKZ Prizren dhe tek Policia e Kosovës, mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP të dërgojë një paralajmërim zyrtar ndaj subjektit politik në fjalë, në mënyrë që kjo zyrë e përdorur në mënyrë jozyrtare të mbetet e mbyllur në ditën e zgjedhjeve; përndryshe, në rast të moszbatimit, të ndërmerren masat ndëshkuese në përputhje me dispozitat ligjore. Parashtruesi i ankesës ka bashkëngjitur disa foto si dëshmi.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik KDTP, theksohet se objekti i përmendur në ankesë është një nga zyrat administrative të KDTP-së, i cili është përdorur për shumë vite si hapësirë zyrtare e Partisë, dhe se për këtë hapësirë është paguar rregullisht qira ndër vite dhe ajo nuk është hapur vetëm për ditën e zgjedhjeve, por përkundrazi shërben si zyrë

administrative e përhershme e partisë. Poashtu në përgjigje theksohet se në këtë zyrë dhe rreth saj nuk ka pasur asnjë veprim apo situatë që do të cenonte vullnetin e zgjedhësve ose që do të përbënte shkelje të Ligjit për Zgjedhjet, edhe pse ankuesi vazhdimisht ka paraqitur ankesa pranë organeve kompetente dhe pranë policisë, dhe pasi nuk është konstatuar asnjë shkelje ligjore, nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Neni 37 i LZP-së, paragrafi 1 përcakton se: *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: veprimet e ndaluara nga ana subjekteve politike gjatë ditës së votimit shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit”.*

Meqenëse pretendimet e palës ankuese i referohen parregullsive në ditën e votimit, paneli vlerësoi se në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme dhe ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme. Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase këto pretendime kane të bëjnë me periudhën e cila ende nuk ka filluar.

Bazuar në arsyet e sipërhënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 115 par. 1, 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.7/2025, datë: 29.08.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.